



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 20.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9632,
DATË 30.10.2006, ‘PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE’, TË NDRYSHUAR”**

I. HYRJE

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datave 6,7, 19 dhe 20 nëntor, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në parim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, propozuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenet 78, 81, 82, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit. Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”.

Në mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, Ministri i Financave dhe Ekonomisë z.Arben Ahmetaj dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie si dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko.

II. QËLLIMI

Ky projektligj ka si qëllim ndërhyrjen në ligjin ku përcaktohen rregullat për vendosjen dhe administrimin e taksave vendore, me qëllim zbatimin sa më të saktë nga ana e njësive të qeverisjes vendore, jo vetëm të dispozitave që lidhen me taksën e pasurisë ndërtësë por edhe të dispozitave të tjera të ligjit për sistemin e taksave vendore.

III. NDRYSHIMET E PROPOZUARA

Nenet e projektligjit propozojnë ndryshime për rishikimin e terminologjisë dhe saktësimin e paqartësive që mund të lindin, sidomos për rastet e përjashtimit nga pagimi i taksave vendore dhe nuk përmbajnë ndryshime në nivelin e taksave. Konkretisht:

- Harmonizimin në tërësi të ligjit jo vetëm me ndryshimet e shumta që ka pësuar ai por edhe me ligjet e tjera pjesë e kuadrit rregullator për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke propozuar në nenet 1, 2 dhe 13 ndryshimin e unifikimit të terminologjisë. Ndërsa, në nenet 3, 6, 7, 14 dhe 14 propozohet riformatimi i 4 anekseve të ligjit në përputhje me ndarjen e re administrativo- territoriale dhe shfuqizimin i 3 të tjerave siç është aneksi për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor, aneksi për taksimin e biznesit të vogël dhe aneksi për nivelin tregues të taksës së zënies së hapësirës publike, në përputhje me ndryshimet që kanë pësuar edhe dispozitat, referencë e të cilave kanë qënë anekset e sipërpërmendura.
- Saktësimin e dispozitave që trajtojnë përjashtimin nga taksa e ndërtesës për kategorinë e pensionistëve dhe ndërtesat kulturore, me qëllim kufizimin e rasteve për shmangien nga pagimi i kësaj takse. Kështu, në nenin 4, propozohet që të përjashtohen jo vetëm ndërtesat e banimit të familjeve që përbëhen vetëm nga pensionistë por edhe të familjeve të pensionistëve që kanë persona të tjerë në ngarkim, të cilët janë të paaftë për punë, por vetëm për ato ndërtesa të deklaruara si vendbanim. Po në nenin 4, propozohet që ndërtesat kulturore sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës/ trashëgimisë kulturore të përfitojnë përjashtimin nga taksa e ndërtesës vetëm për rastet kur këto ndërtesa përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- Rifomulimin e pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 27, të ligjit me qëllim qartësimin e dispozitës që trajton taksën e ndikimit në infrastrukturë. Në pikën 2, të riformuluar propozohet të shtohet një paragraf, sipas të cilit shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese dhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit do të jetë në masën 4-8% të çmimit të shitjes për metër katror. Në pikën 3, shkronja a), të riformuluar propozohet që përveç ndërtesave në sektorin e turizmit, industrisë dhe ndërtesave për qëllime publike, të taksohen në një shkallë 1-3% (2-4 % për Bashkinë Tiranë) edhe ndërtesat e sektorit të bujqësisë, ndërtesat individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, qofshin këto të ndërtuara vetë nga individë apo nga ndonjë sipërmarrës. Ndërsa për ndërtesat që janë në proces legalizimi dispozita e riformuluar kushtëzon marrjen e lejes së legalizimit vetëm mbasi të jetë vertetuar pagesa e taksës prej 0.5% e vlerës së investimi.
- Rishikimin e dispozitave që trajtojnë taksën e tabelës, në përputhje me ndryshimet dhe kategorizimet e miratuara vitin e shkuar në aneksin 7 “Taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive”. Në nenin 10, të projektligjit specifikohet që taksa e tabelës do të llogaritet mbi bazë vjetore, më përjashtim të rasteve kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të

përkohshme. Gjithashtu, në dispozitë propozohet që përveç tabelës së parë identifikuese të subjektit, çdo tabelë tjetër identifikuese, me përjashtim të tabelave orientuese, të taksohet sipas kategorisë së tabelave për qëllime reklamimi, pra më shumë.

- Rifomulimin e pikës 4, të nenit 35, ku përcaktohen tarifat vendore nëpërmjet propozimit për vendosjen e tarifës, vetëm në rastin kur subjektet rrjeteve kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik përdorin tubacione, kanale dhe rrjetet e tjera infrastrukturore, të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, dispozita vendos kushtin që të ardhurat nga këto tarifa të shërbejnë për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.

IV. EFEKTET FINANCIARE

Ky projektligj nuk paraqet efekte në buxhetin e shtetit dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

V. DISKUTIMET NË KOMISION

Diskutimet në Komision u fokusuan tek mundësia e reduktimit apo edhe zerimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat e banimit në zonat rurale, që është në linjë edhe me politikën e “100 fshatrave”, dhe që ka si qëllimin kufizimin e rasteve të braktisjes së zonave rurale nëpërmjet rikthimit të këtyre zonave në qendra të mirëfillta të zhvillimit ekonomik, rural, bujqësor, kulturor.

Gjithashtu, anëtarët e Komisionit kërkuan që të shikohet mundësia e vendosjes së tarifave nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore jo vetëm për rastet kur subjektet e rrjeteve kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik përdorin tubacione, kanale dhe rrjetet e tjera infrastrukturore por edhe për rastet kur përdorin hapësirat ajrore.

Ndërsa, në seancën dëgjimore me Bankën e Shqipërisë, nga ana e Guvernatorit z.Gent Sejko u vlerësua fakti se paketa fiskale e këtij viti, nuk parashikonte ndryshime rrënjësore në sistemin tatimor duke nxitur qëndrueshmërinë e sistemit tatimor, që ndikon pozitivisht për përmirësimin e klimës së biznesit për investitorët vendas dhe të huaj.

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni konstatoi se ndryshimet e propozuara tani së bashku me ndryshimet e tjera të bëra në korrik të këtij viti, për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga taksa e investimeve në infrastrukturë të strukturave akomoduese, të çertifikuara, si agroturizëm, kompletojnë politikat e qeverisë në drejtim të zgjerimit të të ardhurave tatimore vendore dhe nxitjen e përmirësimit të klimës së biznesit.

Komisioni, mbasi mori në shqyrtim edhe raportet e Komisionit për Veprimtarinë, Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e miratoi në parim projektligjin me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

KRYETARI

Blerina GJYLAMETI

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 27.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9632,
DATË 30.10.2006, ‘PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE’, TË NDRYSHUAR”
(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 26 dhe 27 nëntor 2017, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”. Projektligji është pjesë e paketës së projektligjeve financiare që shoqërojnë projektbuxhetin 2019.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 22 nëntor 2017. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 32-38 si dhe nenet 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 26 nëntor ishin të pranishëm përfaqësues nga shoqatat e biznesit si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri, *Dhoma Gjermane e Tregtisë* dhe Industrisë në Shqipëri dhe Biznes Albania. Ndërsa, në mbledhjen e datës 27 nëntor ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

Ndryshimet dhe shtesat kryesore të propozuara nga Këshilli i Ministrave lidhen me rishikimin e terminologjisë së ligjit dhe saktësimin e paqartësive që mund të lindin,, me qëllim zbatimin sa më të saktë nga ana e njësive të qeverisjes vendore, jo vetëm të dispozitave që lidhen me taksën e pasurisë ndërtesë por edhe të dispozitave të tjera të ligjit për sistemin e taksave vendore, dhe më konkretisht:

- Harmonizimin në tërësi të ligjit me ligjet e tjera pjesë e kuadrit rregullator për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Saktësimin e dispozitave që trajtojnë përjashtimin nga taksa e ndërtesës për kategorinë e pensionistëve dhe ndërtesat kulturore, me qëllim kufizimin e rasteve për shmangien nga pagimi i kësaj takse.
- Rishikimin e dispozitës që trajton taksën e ndikimit në infrastrukturë duke propozuar që të jenë objekte të kësaj takse ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese, ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit, ndërtesat e sektorit të bujqësisë, dhe ndërtesat individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, qofshin këto të ndërtuara vetë nga individë apo nga ndonjë sipërmarrës.
- Rishikimin e dispozitave që trajtojnë taksën e tabelës, në përputhje me ndryshimet dhe kategorizimet e miratuara vitin e shkuar në aneksin 7 “Taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive”.
- Vendosjen e tarifës, vetëm në rastin kur subjektet rrjeteve kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik përdorin tubacione, kanale dhe rrjetet e tjera infrastrukturore, të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ky projektligj nuk paraqet efekte në buxhetin e shtetit dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjatë diskutimeve në Komision përfaqësues të shoqatave të biznesit përshëndetën ndryshimet në këtë projektligj, që lidhen me vendosjen e rregullave më të qarta dhe sakta për administrimin e taksave vendore. Megjithatë, përfaqësues të disa shoqatave i sugjeruan Komisionit rishikimin e mëtejshëm të taksës së ndikimit në infrastrukturë, ku sipas tyre bashkitë e mëdha vendosin nivelin maksimal të taksës prej 8% të vlerës së investimit në mënyrë të paargumentuar.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni mbasi mori në shqyrtim edhe raportet e Komisionit për Veprimtarinë, Prodhuesë, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, e miratoi projektligjin nen për nen dhe në tërësi me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me ndryshimet e mëposhtme:

- Neni 2, fjalët “bashkisë” zëvendësohen me fjalët “këshilli i bashkisë”
- Në nenin 4, pika 1, shkronja ë), riformulohet me këtë përmbajtje:

“ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;”.

- Në nenin 9, pikën 3, pas shkronjës c), shtohet shkronja ç) me këtë përmbajtje:

“ç) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 (zero) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.”

- Aneksi 1, që i bashkëlidhet projektligjit zëvendësohet me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATORE

KRYETARI

Blerina GJYLAMETI

Erjon BRAÇE